



UNIVERSITETI I MITROVICËS
'ISA BOLETINI'



THIRRJE PËR APLIKIM

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" fton studentët e interesuar që të aplikojnë për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare studentore "Harvard National Model United Nations 2017" e cila organizohet nga organizatat studentore të Universitetit Harvard në SHBA dhe e cila mbahet në Boston, SHBA në muajin shkurt 2017.

Konferenca "Harvard National Model United Nations 2017" është konferenca më prestigjioze studentore për simulimin e Kombeve të Bashkuara (MUN) e cila ka një histori mbi 55 vjeçare të organizimit të saj. Çdo vit, konferenca HNMUN mbledh mbi 3,000 studentë nga e gjithë bota, ku simulohet puna e organeve dhe organizatave të OKB-së. Konferenca ka karakter garues dhe ka për qëllim të zhvillojë aftësitë diplomatike, të negociimit, të folurit publik, ndërkuptimin dhe shkëmbimin kulturor.

Për më shumë rreth konferencës HNMUN 2017, vizitoni web-faqen www.hnmun.org

Të drejtë aplikimi për pjesëmarrje në konferencë kanë të gjithë studentët e Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" që plotësojnë kushtet në vijim:

- Janë studentë të vitit të dytë ose më lartë në UMIB në ndonjërin prej fakulteteve të UMIB;
- Kanë notë mesatare mbi 8.00;
- Njohin shkëlqyeshëm gjuhën angleze.

Për të aplikuar kandidatët duhet të dërgojnë në formë elektronike dokumentet në vijim në e-mail adresën hnmun.umib@gmail.com:

- CV (në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatën e notave ose dëshmi për notën mesatare.

Afati i fundit për aplikim është data 12 dhjetor 2016, në ora 16:00. Aplikimet e paraqitura jashtë këtij afati nuk do të merren parasysh.

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" do të përzgjedhë deri në gjashtë (6) studentë në bazë të kritereve objektive dhe të meritës.